

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 Për Fondet Pensionale në Kosovë me ndryshim plotësimet e mëtutjeshme të këtij Ligji. FKPK-ja, në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës me të dhënat si në vijim:

Titulli i pozitës:	ZYRTAR PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIK (1 POZITË)
Mbikëqyrësi	Drejtori i Departamentit
Orët e punës:	40 orë në javë
Numri i referencës:	KON052026
Kohëzgjatja e emërimit:	Kontratë 1 vjeçare (me mundësi vazhdimi)
Adresa:	Rr. Perandori Justinian Nr. 71, 10000 Prishtinë

Përmbledhja e përgjegjësiave

- Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun ndër të tjera është përgjegjës për: Hartimin e Strategjisë së Komunikimit me Publik; Zbatimin e aktiviteteve të komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun, përfshirë prononcimet për media; Hartimin e Raportit Vjetor; Mirëmbajtjen e përmbajtjes dhe publikimin e raporteve në faqen zyrtare. Ky pozicion mbështet menaxhmentin dhe Bordin me informacione dhe analiza, mirëmban kanalet e komunikimit (ueb-faqen dhe rrjetet sociale) si dhe koordinon aktivitetet e përkthimit.

Kriteret e konkursit:

Edukimi:

- Diplomë Universitare.**

Përvoja/njohuri të
dhe Aftësitë:

- Përvojë minimale:** 4 vite përvojë pune relevante në fushën e komunikimit, marrëdhënieve me publikun ose media.
- Njohuri të avancuara: Në hartimin e strategjive të komunikimit, menaxhimin e krizave, menaxhimin e rrjeteve sociale, si dhe në bashkëpunimin dhe mbajtjen e raporteve me mediat.
- Njohuri të avancuara në programet dhe softuerët e nevojshëm për përgatitjen e raporteve të strukturuar e prezantimeve profesionale.
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze (shkrim, lexim dhe komunikim).
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi (me shkrim dhe me gojë), aftësi të larta ndërpersonale, si dhe etikë të lartë profesionale e integritet.

Aftësi dhe
njohuri shtesë
të dëshiruara:

- Aftësi në menaxhimin e dokumenteve digjitale.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunuese në mjedis të ndjeshëm dhe konfidencial.
- Njohja e një gjuhe tjetër zyrtare të Republikës së Kosovës, është përparësi.

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Afati për konkurrim është i hapur prej 20 korrik 2026 e deri më 10 gusht 2026, ora 16:00.
- Aplikimi bëhet vetëm përmes postës elektronike (e-mail) në: recruitment@trusti.org, duke vendosur si titull "KON052026", dhe duke bashkëngjitur dokumentet në vijim (në shqip, anglisht ose serbisht) në formatin PDF :
 - Biografinë (CV);
 - Letrën motivuese;
 - Referencat apo dokumente të tjera që e dëshmojnë përvojën e kërkuar në lëminë përkatëse;
 - Kopjet e certifikatave profesionale dhe diplomave universitare e post-universitare të deklaruara në CV;
 - Certifikata e historisë penale.

Shënim:

- Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit do të shqyrtohen dhe kontaktohen për më tutje.
- Kandidatët mund t'i nënshtrohen një testi preliminar. Pas testit mund të përzgjidhen kandidatët për intervistë..
- Aplikacionet pa bashkëngjitur “Dokumentet për aplikim” (pikat e obligueshme 1 deri 5) si dhe ato të dorëzuara pas afatit, NUK do të shqyrtohen. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e konkursit do të kontaktohen.

FKPK-ja është punëdhënëse që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!